

PJESA E PARE:

PROBLEMET E ARSIMIMIT TE FEMIJEVE

SITUATA E ARSIMIT PARA-UNIVERSITAR NE SHQIPERI

1. Background

Sistemi ynë arsimor, gjatë dhjetëvjeçarit të fundit pësoi ndryshime dhe tronditje të mëdha, kryesisht **fizike** dhe **psiko-sociale** duke penguar krijimin e kushteve të domosdoshme për një aktivitet mësimor normal. Në impostimin krejtësisht të ri të aktorëve të sistemit (nxënës-mësues-administratë-familje-komunitet) lind nevoja për rregulla të reja loje. Ekspozimi ndaj ekonomisë së tregut krijoi një skenë shumë më të komplikuar. Sistemi aktual karakterizohet nga një përzierje elementësh përmbajtësorë, menaxherialë dhe zhvillimorë, tipikë për një periudhë tranzicioni, por duke tentuar drejt një sistemi të hapur e demokratik

Arsimi i detyruar është i ndarë në dy cikle, arsim fillor me kohëzgjatje 4 vjeçare dhe arsim i mesëm i ulët me kohëzgjatje 4 vite të tjera shkollimi. Në shkallë kombëtare numri i shkollave 8-vjeçare është 1838, numri i nxënësve është 515782 dhe numri i mësuesve është 27820. Në zonat rurale ndjekin arsimin bazë rreth 96 % e fëmijëve. Mësuesit pa arsim përkatës variojnë nga 13% e mësuesve të ciklit të ulët deri në 18.2 % të atyre në kl. 5-8. Në fshat 49.7 % e numrit të përgjithshëm të klasave janë kolektive, kurse në ciklin e lartë 20.3 % .

2. Mangësi të sistemit arsimor

Aspekti cilësor

Sistemi aktual është i centralizuar; pjesëmarrja në vendimmarrje e aktorëve dhe e institucioneve të tjera ndjehet shumë pak. Konstatohet se përmbajtja në mjaft raste është e papërshtatshme dhe mësuesit janë të pakualifikuar dhe të pamotivuar për t'u ofruar të gjithë nxënësve shanset e nevojshme për arsimim. Akoma një pjesë e mirë e nxënësve nuk arrijnë të përfitojnë as minimumin e mundshëm nga procesi mësimor edhe pse e ndjekin rregullisht atë (dukuria e braktisjes së fshehtë).

Është i konsiderueshëm numri i fëmijëve që braktisin shkollën si dhe i atyre që nuk arrijnë të vazhdojnë nivelin pasardhës të shkollimit. Gjate këtyre viteve të tranzicionit në arsim ky fenomen ka pesuar luhatje dhe, sipas statistikave të MASH, braktisja e shkolles nga femijet ka arritur pikun e vet në vitet 1991-1992 me 6.31 % dhe me pas ka pesuar rënie në 2.4 % në vitin shkollor 2001-2002 dhe aktualisht projeksioni i braktisjes së shkolles në shkallë kombëtare është 1.8%. Nga studimet rezulton se rreth 35% e nxënësve e braktisin shkollën për arsye të ardhurave të pamjaftueshme dhe 1/5 e nxënësve e braktisin arsimin për arsye të nivelit të ulët të cilësive. Edhe ndjekja e niveleve më të larta të arsimit për nxënës të perfundojnë arsimin 8-vjeçar nuk është në nivelin që kërkohej. Kështu nga 64% e nxënësve që e ndjekin arsimin e mesëm të përgjithshëm aktualisht, synohet në 70 % deri në vitin 2005 dhe për arsimin profesional nga 18 % që është aktualisht në 30 % deri në vitin 2005.¹

Kurrikula

Programet mësimore janë të unifikuara në të gjithë nivelet e sistemit arsimor. Në to ndjehet mungesa e koherencës së brendshme dhe e lidhjeve ndër-lëndore midis programeve të së njëjtës klasë, midis viteve të të njëjtit cikël shkollimi. Përmbajtja e programeve aktuale reflekton prirjen tradicionale drejt akademizmit të theksuar dhe zbatimi i tyre vuan nga formalizmi dhe verbalizmi dhe nuk krijon shanse për mësimnxënie efektive. Cilësia e teksteve shkollore në drejtim të përmbajtjes, cilësisë së figurave, letrës, lidhjes etj. nuk është në nivelin që kërkohej.

Infrastruktura dhe burimet materiale. Infrastruktura është e papërshtatshme, sepse mbetet ende i madh numri i shkollave të amortizuara dhe ekzistojnë mungesa të theksuara të pajisjeve shkollore. Shumica e klasave nuk plotësojnë standartet e nevojshme për qëndrim dhe punë normale të nxënësve në procesin mësimor. Ka mungesë të paisjeve dhe orëndive shkollore didaktike, gjë që ndikon negativisht në cilësinë e mësimdhënies.

¹ Te dhenat janë marrë nga "Braktisja e shkolles – percaktuesit dhe rrjedhjat", studim i botuar nga Qendra për Arsimin Demokratik, Tiranë 2003

BUXHETI I SHTETIT PER ARSIMIN DHE FEMIJET

Buxheti i Qeverise për vitin 2006 akorduar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në total është 26,228,000 Lekë.

Nga kjo shumë pothuajse më tepër se gjysma shkon për arsimin bazë (përfshirë parashkollorin), një shumë gati 5 herë më e vogël se e para shkon për arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe një shumë tjetër sa gjysma e shumës akorduar për arsimin e mesëm të përgjithshëm shkon për arsimin e mesëm profesional. Ndërsa shuma e venë në dispozicion për programet arsimore dhe trainimin e mësuesve krahasuar me buxhetin e përgjithshëm për arsimin është rreth 3% e saj.

Nga buxheti i përgjithshëm për arsimin janë venë në dispozicion për investime në arsim 19.3% e shumës, e ndare kjo në: investime për arsimin baze 9.3%; investime për arsimin e mesëm të përgjithshëm 4%; investime për arsimin e mesëm profesional 1.6%; dhe investime për programet arsimore dhe trainimin e mësuesve 0.02%, pra një përqindje shumë e vogël, e papërfillshme krahasuar me buxhetin për arsimin në total.

BUXHETI I QEVERISE SHQIPTARE PER ARSIMIN – VITI 2006

Nr.	Buxheti I vitit 2006	ne mije Lek	ne %
1	Buxheti i Qeverise (ne total)	155,698,538	100
2	Buxheti i Akorduar nga Qeveria per Ministrine e Arsimit dhe Shkences	26,228,000	16.8

BUXHETI PER ARSIMIN

Nr.	Buxheti per Arsimin sipas kategorive	ne mije Lek	ne %
1	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	14,032,686	53.5
2	Arsimi i Mesem (I pergjithshem)	2,933,473	11.1
3	Arsimi I Mesem (rofessional)	1,627,543	6.2
4	Programet Arsimore dhe Trainimi i Mesuesve	82,638	0.3
5	Investimet per Arsimin (ne total)	5,068,000	19.3

INVESTIMET PER ARSIMIN

Nr.	Investimet per Arsimin sipas kategorive	ne mije Lek	ne %
1	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	2,453,000	9.3
2	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	1,050,000	4
3	Arsimi I Mesem (professional)	440,000	1.6
4	Programet Arsimore dhe Trainimi i Mesuesve	7,000	0.02

Te dhenat jane marre nga materiali i publikuar ne faqen zyrtare te internetit te Keshillit te Ministrave

FEMIJET QE PUNOJNE, FEMIJET E RRUGES DHE ARSIMIMI I TYRE

FEMIJET QE PUNOJNE

a) Problemi

- Pamjaftueshmeria e programeve dhe politikave kombetare per eleminimin e punesimit te femijeve,
- Ngritja e politikave per identifikimin e numrit te femijeve qe punojne,
- Varferia ekstreme, kultura familjare dhe mungesa e nje sistemi te forte arsimimi,
- Mungesa e nje bashkepunimi per rritjen e ndergjegjesimit te opinionit publik per pasojat e punes se femijeve,
- Ekzistenca e nje hendeku ne legjislacion per mbikqyrjen e aktiviteteve jo-formale te punes se femijeve,
- Mungesa e sistemit te mbrojtjes dhe kujdesit ndaj femijes, sistemit te referimit dhe sherbimeve te kualifikuara e ben te veshtire rehabilitimin e femijeve qe punojne dhe femijeve te rruges. Mungesa e sanksioneve ndaj familjeve qe shfrytezojne krahun e punes se femijes, qofte ne Kodin e Punes, Kodin e Familjes dhe ne Kodin Penal, ben qe femijet te gjenden te pa mbrojtur nga ligji dhe institucionet e zbatimit te ligjit.
- Mungesa e masave per zbatimin e ligjit per arsimin e detyrueshem,
- Mungesa e nje sistemi monitorimi per evidentimin, vleresimin dhe adresimin e problemit,
- Mungesa e programeve per aplikimin e pjesmarrjes se femijeve ne vendim-marrje,

b) Rekomandime

- Te miratohen ndryshime legjislative ne Kodin e Punes, Kodin Penal dhe Kodin e Familjes, per te mbrojtur femijet nga çdo forme e shfrytezimit ekonomik, pavaresisht se kush eshte shfrytezuesi i femijes;
- Te perpilohet dhe miratohet nje ligj per te drejtat e femijeve ne Shqiperi;
- Te shtohet buxheti i shtetit per sherbimet per femijet qe punojne perfshire edhe arsimimin e tyre.
- Te nxitet permiresimin legjislativ ne Kodin e Punes, Kodin Penal dhe Kodin e Familjes, per te bere te mundur mbrojtjen e femijeve nga çdo forme e shfrytezimit ekonomik;
- Te merren masa per te bere te mundur perfshirjen ne arsimin te detyrueshem te çdo femije ne Shqiperi;
- Te rritet buxheti per arsimin dhe ndihmen sociale, perfshire ketu edhe krijimin e mundesive per te rritur ndihmen ekonomike per femijet e varfer qe ndjekin shkollen.

FEMIJET E RRUGES

a) Problemi

- Mungesa e programeve per identifikimin e numrit te sakte te femijeve te rruges,
- Mungesa e politikave dhe sherbimeve komunitare, per rehabilitimin dhe ri-integrimin e femijeve te rruges,
- Mungesa e nje sistemi referimi per femijet e rruges,
- Mungesa e qendrave ditore dhe rezidenciale per femijet e rruges,
- Mungesa e politikave arsimore per mesim alternativ per femijet e rruges,
- Mungesa e politikave nderherese per familjen e femijeve te rruges,

b) Rekomandime

- Krijimin e politikave mbrojtese per femijet e rruges,
- Krijimi i programeve qe ofrojne sherbime per identifikimin, trajtimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e femijeve te rruges,
- Te permiresohet struktura dhe te shtohen kapacitetet e Sherbimit Social Shteteror.
- Te krijohen dhe zbatohen politika per permiresimin e situates ekonomike te familjeve te femijeve te rruges,

FEMIJET ROME NE SHQIPERI

Komuniteti Rom

Komuniteti Rom konsiderohet si një minoritet gjuhësor. Të dhënat statistikore lidhur me numrin e Romëve që jetojnë në Shqipëri mungojnë, pasi një regjistrim i përgjithshëm i tyre nuk është bërë asnjëherë. Nga studimet e bëra supozohet se kanë ardhur nga India pastaj nëpërmjet Ballkanit në Europë. Origjina e tyre njihet jo për arsye të dëshmimeve të sakta historike por kryesisht nga analizat gjuhësore.

Në vitin 1930 sipas vlerësimeve popullore në Shqipëri kishte 20,000 Rom në të gjithë vendin. Në 1980 kishte 62,000 romë të vlerësuar sipas burimeve Franceze. Më 1995 Grupi Ndërkombëtar i të Drejtave të Minoriteteve vlerësoi se numri i Romëve ishte midis 90,000 – 100,000 vetë. Ndërsa Universiteti i Maryland-it, SHBA në 1995 deklaroi se ka deri në 120,000 Romë që jetojnë në Shqipëri.²

Gjendja aktuale e Komunitetit dhe Fëmijëve Romë

Komuniteti Rom është i shpërndarë pothuajse në të gjitha zonat, kjo e lidhur ngushtë edhe me elementë të kulturës së tyre. Një pjesë e konsiderueshme e këtij komuniteti përballet me vështirësi të mëdha për sa i përket strehimit, arsimimit, punisimit, pra nuk ka një gjendje të qëndrueshme ekonomike e sociale. Kjo ndryshueshmëri ndikon në gjetjen e zgjedhjeve afatgjata dhe anashjelltas. Karakteristikat e jetesës dhe familjes rome kanë një ndikim të konsiderueshëm tek fëmijët, të cilët duke mos marrë arsimimin e duhur, nuk i përshtaten kërkesave të tregut të punës, dhe mundësitë janë shumë më të kufizuara se pjesa tjetër e popullsisë dhe si rezultat sjellin qarkullimin e varfërisë dhe të problemeve sociale në një cikël të mbyllur i trashëguar nëpër breza.

Fëmijët Rom, janë shumica analfabetë kjo për shkak të vështirësive gjuhësore që kanë fëmijët në klasën e parë, të varfërisë që pllakos familjet e tyre, të largësisë që kanë vendbanimet e tyre nga institucionet shkollore si dhe të mentalitetit të gabuar të prindërve. Niveli i ulët arsimor është problemi më serioz që pengon integrimin e këtij komuniteti me popullsinë jorome. 62% e romëve të moshës 7-20 vjeç nuk kanë shkuar asnjëherë në shkollë, 53% e romëve të moshës mbi 6 vjeç nuk e kanë përfunduar klasën e parë. dhe 67% e familjeve rome nuk mund t'i përballojnë shpenzimet për blerjen e librave³.

Duke marrë në konsideratë faktet e mesiperme si dhe ritmin e lartë të shtimit të popullsisë (mesatarja e fëmijëve të një familje rome variaon nga 5-6 fëmijë), ne mund të kuptojmë rëndësinë që marrin perpjekjet për edukimin e brezit të ri të komunitetit Rom.

Çfarë është bërë deri më sot?

Strategjia Kombëtare e Shqipërisë për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Rom (2003-2015) u miratua në vitin 2003 me anë të një vendimi të Këshillit të Ministrave. Strategjia u bazua në vlerësimin e varfërisë së Bankës Botërore të vitit 2002, që i identifikonte Romët si një ndër komunitetet më të prekura nga varfëria dhe rekomandoi një strategji me fokus më specifik për ta. Nëpërmjet synimeve të kësaj strategjie mund të evidentojmë: zbutjen e varfërisë, inkurajimin e përfshirjes së Romëve në jetën publike dhe mbështetjen për ruajtjen e identitetit të Romëve. Miratimi i strategjisë u mirëprit nga OJQ-të Rome dhe u vlerësua nga ekspertët ndërkombëtarë për aspektin e saj gjithpërfshirës dhe në veçanti për sensitivitetin e saj për rininë dhe aspektin gjinor. Megjithatë, shqetësimi kryesor mbetet vënia në zbatim e kësaj strategjie.

² Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom 2003-2015 p.5

³ Studim i Bankës Botërore, Hermine De Soto dhe Ilir Gedeshi p.41

Rekomandime:

- Në mënyrë që të ritet ndërgjegjësimi publik dhe respekti për diversitetin do të duhej të organizoheshin:
 - Trainime të mësuesve që japin mësim në shkolla ku janë të pranishëm fëmijë të komunitetit rom në lidhje me normat dhe vlerat kulturore të këtij komuniteti si dhe nevojat e specifikat e veçanta të këtij komuniteti.
 - Përgatitja e materialeve dhe klasave të veçanta mbi historinë dhe kulturën Rome për të ndërgjegjësuar fëmijët në lidhje me vlerat, kulturën dhe historinë respektive të tyre.
- Strategjitë lokale dhe/ose planet e veprimit duhet të marrin në konsideratë dhe prioritetet e komuniteteve Rome, duke shfrytëzuar dhe eksperiencën apo ekspertizën e tyre.
- Të gjenden mënyrat për edukimin apo dhënien e informacionit në lidhje me edukimin seksual dhe programet e planifikimit familjar.
- Ngritja dhe mbështetja e kopshteve në zonat e komunitetit Rom, në shërbim kjo të përgatitjes së fëmijëve me arsimin parashkollor.
- Mundësia e sigurimit falas për familjet shumë të varfëra Rome të librave, materialeve, apo shërbimeve të tjera që ofron shkolla, me kushtin e ndjekjes rregullisht të shkollës nga fëmijët e tyre.
- Ritja e mundësisë së ndjekjes së shkollave të mesme apo të larta përmes ofrimit të bursave specifike, apo metodave të tjera motivuese në bashkëpunim kjo me Qeverisjet lokale dhe organizatat Rome.
- Programet e fokusuara për Romët duhet të zhvillohen dhe të integrohen në të gjitha politikat përkatëse sektoriale, për të siguruar risurset e nevojshme dhe një metodë gjithpërfshirëse për zhvendosjen e të gjitha pengesave që hasin burrat, gratë, të rinjtë apo fëmijët Romë.

Burime të shfrytëzuara për këtë material:

- Strategjia Kombetare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom 2003-2015
- Makro – Minority Rights Group International dhe Unioni i Romëve të Shqipërisë “ Amaro Drom”
- Raport mbi trafikimin e personave në komunitetin Rom Shqipëtar – Amaro Drom 2005.

FEMIJET ME AFTESI TE KUFIZUAR

1. Background

Duke u bazuar në të dhëna të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta, numri i Personave me Aftësi të Kufizuar të lindur ose të fituar deri në 21 vjec është 44,794 persona me aftësi të kufizuar, prej të cilëve rreth 18500 janë fëmijë të moshës shkollore.

Duke iu referuar një studimi të Prof.As Dr. Virgjil Nano[1], mësohet se 1 në 10 fëmijë lind ose ndesh gjatë jetës dëmtime të ndryshme, të cilat komprometojnë zhvillimin e tij individual. Madje, po të merren në konsideratë edhe mospërputhjet midis mundësive që kanë fëmijët dhe pengesat përpara të cilave ata vihen, si keqtrajtimet, abuzimet, dhunimet, braktisjet, apo faktorë të tjerë social-ekonomikë dhe zhvillimorë, mund të thuhet pa frikë se gati 20 % e fëmijëve në periudhën e shkollimit manifestojnë vështirësi serioze apo nevoja speciale për të nxënë.

Sistemi arsimor ekzistues nuk arrin të plotësojë as 2-3 % të nevojave në fushën e edukimit special. Shumica e qyteteve dhe e fshatrave mbeten të pambuluara me shërbim arsimor të përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuar.

Për 18,500 fëmijë me aftësi të kufizuar ekzistojnë vetëm:

a) 6 shkolla të veçanta , 3 qendra ditore, 3 qendra rezidenciale kryesisht për fëmijët me aftësi të kufizuar intelektuale dhe 2 institute për fëmijët me aftësi të kufizuar në shikim dhe dëgjim. Numri i fëmijëve në këto shkolla shkon rreth 850 .

b) Përveç kësaj, në institucionet e përmendura më lartë, është vërejtur se ka një ulje të efektivitetit të punës, që duket se ndikohet jo vetëm nga izolimi social që ju bëhet fëmijëve në to, por edhe nga heterogjeniteti i problemeve që shfaqin nxënësit brenda një klase speciale, zhvillimi i programeve mësimore që shpesh nuk janë të përshtatshme për fëmijët, mungesa e një stafi të kualifikuar dhe një shërbimi të specializuar për të bërë ndërhyrje të përshtatshme edukative dhe terapeutike, bashkëpunimi i dobët me strukturat komunitare, teknologjia e pamjaftueshme për mësimdhënie cilësore, etj. (Prof.As.Dr. Ardian Turku, (studim i kryer në kuadër të projektit "Arsimi Special i Integruar", Librazhd, 2001).

Ligji nuk i ndalon fëmijët me aftësi të kufizuar të frekuentojnë shkollat e zakonshme, por as nuk garanton edukim të përshtatshëm për ta.

2. Problemet

- Në Shqipëri ekziston një kuadër legjislativ, por ai nuk përfshin të gjitha të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe zbatimi i ligjeve nuk shoqërohet gjithmonë me fondet e mjaftueshme për zbatimin e tyre në praktikë.
- Institucioni më i lartë përgjegjës për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara është Ministria e Arsimit, por pranë kësaj ministrie nuk ka asnjë departament që të kujdeset për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar edhe pse ajo administron drejtpërdrejt tërë shkollat e fëmijëve me aftësi të kufizuar që ekzistojnë në shkallë vendi. Nga ana tjetër, psikologët dhe punonjësit social ende nuk janë përfshirë në sistemin e shërbimit shëndetësor.
- Ka paqartësi ligjore në lidhje me procedurat e pranimit, vlerësimit fillestar dhe rregjistrimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar në klasën e parë të shkollës së zakonshme;
- Mungojnë aktet normative që rregullojnë punën me PEI (planin edukativ individual);
- Nuk gjejnë shprehje të plotë dhe aspak motivuese, çështje të tilla si kualifikimi i mësuesve, ngarkesa mësimore e tyre dhe vlerësimi financiar;
- Nuk saktësohet marrëdhënia mes shkollës së zakonshme dhe sistemit të shërbimeve sociale dhe psikologjike;

- Nuk janë krijuar strukturat mbështetëse në MASH, DRA dhe në drejtoritë e shkollave, që të mund të sigurojnë koordinimin dhe mbarëvajtjen e procesit të integritit dhe gjithpërfshirjes në arsim;
- Kurrikula, programet dhe tekstet e shkollës së zakonshme nuk i përshtaten arsimit gjithpërfshirës;
- Mungojnë mjediset e përshtatshme në shkollë, qendrat burimore, mjetet dhe materialet e tjera të nevojshme për procesin gjithpërfshirës;

Të gjitha këto tregojnë se harmonizimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor me standardet ndërkombëtare për përkatësinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme, ende përbën një proces që kërkon vëmendje.

3. Rekomandime

- Eshtë e domosdoshme që të gjenerohen politika mbështetëse dhe të merren masa konkrete për ta bërë ligjin të njohur dhe të zbatueshëm në shkallë vendi.
- Këto politika duhen mbështetur në objektivin "Sigurimi i arsimit optimal për personat me aftësi të kufizuara" të Strategjise Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara 2005.
- Puna për hartimin e politikave duhet paraprirë nga një studim i mundësive dhe nevojave të vendit (feasibility study) për të siguruar të drejtën për arsim optimal të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Për hartimin e politikave duhet ngritur një grup pune me specialistët më të mirë të vendit në këtë fushe që përfaqsojnë njohuritë bashkëkohore ndërkombëtare dhe përvojën kombëtare në arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara të natyrave të ndryshme.
- Politikat e hartuara duhen pasqyruar në Dispozitat Normative.
- Në pjesën më të madhe të stafit akademik drejtues reflektohet një kuptim i paqartë për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe arsimin gjithpërfshirës;

[1] Revista Pedagogjike, Nr. 1-2, v. 2000

PJESA E DYTE:

PROBLEMET E MESUESVE DHE KURIKULES

MESUESIT DHE PROBLEMET QE NDESHIN NE ARSIMIMIN E FEMIJEVE

1. Background

Rreth 40 mije mesues e pedagoge japin mesim ne tere sistemin arsimor ne vendin tone. Vetem ne arsimin e detyrueshem 9-vjecar, rreth 467 mije nxenes ulen ne bankat e shkollave dhe jane ne duart e mesuesve per te pervesuar njohurite e nevojshme per te kaluar ne nivelet e tjera te arsimimit ose per te perballuar kerkesat e tregut te punes.

Jane bere permiresime nga njeri vit ne tjetrin per trajtimin e mesuesve dhe motivimin me te mire te tyre, por akoma vleresimi dhe rendesia e madhe e ketij profesioni per te ardhmen e shoqerise sone nuk reflektohet sa duhet ne kujdesin e Qeverise, per krijimin e kushteve per nje arsim cilesor per te gjithë.

2. Problemet

1. Me gjithë rritjet qe jane bere vit pas viti, akoma pagat e mesuesve jane ne nivele te ulta dhe qe nuk e justifikojne rendesine e madhe te ketij profesioni. Shuma mesatare prej 22 000 leksh ne muaj, (rreth 18 000 leke ne muaj per mesuesit e rinj, dhe rreth 26 000 leke ne muaj per ata qe jane ne fund te karrieres), eshte shume larg kerkesave per nje jetese normale dhe per nje motivim te ketyre punonjesve ne detyren e tyre per pergatitjen e brezit te ri.

Megjithese ka disa vite qe arsimi eshte shpallur sektor prioritar nga qeverite shqiptare te mbeshtetura nga Banka Boterore, akoma nuk po duket ndonje prioritet ne vleresimin e mesuesve persa u perket te ardhurave te tyre dhe familjeve te tyre.

Qeveria aktuale ka premtuar dyfishimin e pagave te mesuesve deri ne fund te mandatit te saj kater vjecar, por me vendimet qe po synon te ndermarre kohet e fundit, duket se ky do te mbetet nje premtim qe veshitare se do te realizohet.

2. Kushtet e punes se mesuesve vazhdojne te jene shume te veshitira dhe nuk krijojne baza per pune cilesore dhe rezultate te larta ne mesimdhene. Eshte e vertete qe jane bere e po vazhdojne te rikonstruktohen e te ndertohen shkolla te reja, por akoma kemi shume probleme, nder te cilat po permendim vetem tre prej tyre:

a. Sigurimi i bazes laboratorike dhe i mjeteve mesimore akoma le shume per te deshruar, gje qe krijon monotoni dhe veshitiresi te tjera ne mesimdhene.

b. Edhe numri i nxenesve ne klase, qe ne disa raste shkon deri ne 50, sidomos ne qytetet e medha eshte nje problem i madh, i cili demton rende cilesine e mesimdhenies dhe veshitreson shume kryerjen me cilesi te detyres nga mesuesit qe perballen me kete dukuri.

c. Ngarkesa mesimore e mesuesve eshte akoma e larte, mbasi ne normen mesimore nuk jane perfshire elementet dytesor sic jane pergatitja per mesim, korrigjimi i detyrave e provimeve, angazhimet me klasen ne kujdestari, oret edukative etj, te cilat e rendojne shume ngarkesen javore te mesuesit.

3. Edhe kualifikimi i mesuesve nuk u pergjigjet akoma kerkesave te kohes, nivelit ne rritje te mesimdhenies, zhvillimit te teknologjise se informimit e komunikimit, zhvillimit te nje arsimit cilesor qe te plotesoje ne vijim kerkesat e procesit te Bolonjes, per t'u integruar ne nivelet europiane. Jane krijuar organizma ne nivel kombetar per kete problem, por akoma ne nivel lokal dhe sidomos ne shkolla kjo pune le shume per te deshruar dhe mesuesit rrezikojne te mbeten mbrapa e te krijojne boshlleqe te medha tek nxenesit ne teresi e sidomos tek ata me nivel nen mesataren.

4. Emerimet pa kriteret e qarta dhe levizjet e pamotivuara krijojne shume probleme, e mbi te gjitha, pasiguri ne radhet e mesuesve, te cilet ne jo pak raste ndjehen te kercenuar dhe te pamotivuar per nje pune sistematike dhe rezultative. Ndikim me te madh ka ky fenomen tek drejtuesit e shkollave, levizjet e te cileve marrin jo rralle edhe karakter politik, por dukuri te tilla vihen re edhe ne radhet e mesuesve, ndaj te cileve nuk mungojne keto qendrime.

5. Pothuajse mungon teresisht motivimi i mesueve per pune ekstra ne shkollë ose jashte saj, sic eshte rasti i nje pune te veçante me nxenesit qe braktisin shkollën, me ata qe punojne ose qe trafikohen, gje qe i sjelle nje dem te madh shkolles dhe vete shoqerise sone. Edhe perpjekjet e sindikatave per te permiresuar kete gjendje ndeshin ne mjaft pengesa e veshtiresi.

6. Nje pjese e mire e ketyre problemeve vjen edhe nga fakti qe akoma mesuesit shqiptare nuk kane Statusin e tyre, nderkohe qe ILO/UNESCO kane publikuar Rekomandimet e tyre per kete Status qe ne vitin 1966, dmth 40 vjet me pare.

3. Rekomandime

Shume organizma jane te angazhuara per te bere permiresime te ndjeshme ne trajtimin e mesuesve dhe te sistemit arsimor ne teresi. Sindikatat e arsimit, FSASH e SPASH, por edhe organizata te tjera te shoqerise civile jane shfaqur shpesh here shume aktive ne qendrimin ndaj ketyre problemeve. Ne emer te te gjithë ketij opinioni, disa nga rekomandimet, ne forme kerkesash jane:

- Te rritet me cdo kusht pjesa e GDP per arsimin duke filluar qe nga buxheti i vitit te ardhshem. Eshte pranuar nga Qeveria aktuale kjo gje, por edhe gjate vitit 2006, me gjithë premtimet e bera, pjesa e GDP per arsimin nuk pesoi ndonje rritje te vecante, dhe, me keq akoma, zera te vecante brenda ketij sistemi pesuan ulje, ne krahasim me vitet e meparshme. Shpallja e arsimit prioritet duhet te shoqerohet me nje buxhet me te madh, qe do te lejonte, jo vetem permiresimin e pozites sociale te mesuesve, nepermjet trajtimit me te mire te tyre, por edhe do te krijonte kushte per investime te domosdoshme ne shkolla , gje qe do te ulte numrin e nxenesve ne klase, do te krijonte bazen e domosdoshme didaktike, mjetet mesimore, pajisjet sipas kerkesave te kohes, si edhe mundesi me te medha kualifikimi dhe zhvillimi te teknologjise se informimit dhe komunikimit ne shkolla.
- Mbeshtetur ne Strategjine e Arsimit parauniversitar dhe ne Programin e Qeverise, qe e konsideron arsimin si sektor prioritar, Ministria e Arsimit, ne konsultim me partneret sociale, te ndertojne e zbatojne nje sistem pagash dhe shperblimesh qe mundeson nje vleresim me te mire te figures e punes se mesuesit e pedagogut dhe nje motivim me te madh te tij, ne baze te angazhimit ne procesin e reformimit e modernizimit te arsimit dhe te cilesise se punes qe kryen.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me sindikatat e arsimit e ne konsultim me aktore te tjere te interesuar, të studiojë ngarkesën mësimore të mësuesve të arsimit parauniversitar, duke përfshirë në elementin “ngarkesë” edhe komponentë të tjerë, të cilët mësuesi i përballon aktualisht, por që nuk i njihen në ngarkesë.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në konsultim me sindikatat, te përcaktojnë kriteret për perzgjedhjen, dhe emrimin e drejtuesve të shkollave dhe mesuesve, duke perfshire ne komisionet e konkurimit edhe perfaqesues te organizatave perfaqesuese te tyre.
- Brenda muajit shtator 2006 të përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe shkencës, në konsultim me sindikatat, kriteret dhe masat për kualifikimin e mësuesve.
- Ministria e Arsimit dhe sindikatat e arsimit te intensifikojne punen e nisur per perfundimin brenda vitit te nje drafti per Statusin e Mesuesit, te cilin ta paraqesin per miratim ne Parlament.

Synimi perfundimtar i gjithë ketyre permiresimeve te jete ngritja e nivelit cilesor te mesuesve dhe motivimi me i mire i tyre, sepse pa mesues cilesor e te motivuar nuk mund te kete reforma cilesore ne sistemin arsimor dhe zhvillim progresiv te shoqerise sone.

SISTEMI KOMBETAR I TRAINIMIT DHE KUALIFIKIMIT TE MESUESVE

Trainimi dhe kualifikimi i mesuesve ne shqiperi, ashtu si dhe ne vendet e tjera, eshte i artikuluar me probleme te natyrave njerzore, politike, arsimore, sociale, profesionale dhe ekonomike.

Mesuesit qe sapo diplomohen nga shkolla te larta te formimit fillestar te mesuesve, titullohen automatikisht mesues te shkalles se katert. Ne prag te plotesimit te pese vjeteve pune ne arsim, ata mund te hyjne ne trainime, per tu certifikuar dhe per te kaluar ne graden (shkallen) e trete: pas pese vjetesh te tjera (gjithsej dhjete vjet pune) per graden e dyte, kurse pas 20 vjetesh pune, mund te marrin graden e pare. Ky eshte sistemi i pare i trainimit te mesuesve dhe kualifikimit per atestim. Pas marrjes se certificates, mesuesit perfitojne dhe rritjen e pages mujore te tyre.

Paralelisht me kete sistem, mesuesit kryejne dhe trainimin e vazhdueshem te tyre, nepermjet seminareve qe zhvillohen ne kryeqytet, neper njesite administrative lokale deri ne nivel shkolle. Mesuesve ne Shqiperi paga baze u rritet ne dy menyra: ne menyre automatike per vjetersi(çdo vit me 2 %), si dhe per graden qe fitojne (me 5 %, + 5 %, + 10 %), respektivisht pas 5:10 dhe 20 vjeteve pune ne arsim.

Atestimi i mesuesve ne Republiken e Shqiperise eshte procesi i organizuar dhe i financuar nga shteti, per perfshirjen vullnetare te mesuesve me vjetersi 5, 10 dhe 20 vjet ne trainimet e detyrueshme te tyre, proces i cili pason me vleresimin qe iu behet mesuesve nga komisionet ne shkalle rrethi e qe çon ne certifikimin e tyre sipas tre shkalleve te kualifikimit, si dhe ne rritjen e pages mujore.

Trainime te vazhdueshme, te cilat nuk çojne ne rritje te pages mujore, formalisht nuk jane te detyrueshme, por, megjithate, shpesh here mesuesit i ndjekin dhe kur per seminarat qe zhvillohen nuk kane ndonje interes per shkak te permbajtjes se tyre, ose per shkak te nivelit te trajnereve. Siç shihet, atestimi eshte artikulum i shume elementeve qe lidhen me trajnimin, vleresimin, certifikimin, dhe kalimin e mesuesve ne nje shkalle te re, si dhe ne rritjen e pages mujore.

Strukturat e trainimit te mesuesve

Sistemi i trajnereve lokale i ngritur ne vitin 1993, funksionoi deri ne vitin 1998, kur ai u suprimua nga Ministria e Arsimit dhe Shkences. Gjate dy-tre vjeteve qe pasuan trainimi i mesuesve nuk pati me organizime ne shkalle kombetare , madje shume pak trainime u bene edhe ne shkalle lokale. Gjate kesaj kohe MASH ngarkoi shkollat qe t'i benin trainimet e mesueve, nepermjet te ashtuquajturit kualifikim te brendshem, i cili nuk pati asnje mbeshtetje kombetare.

Me 1 shkurt 2005, pothuaj nje vit e gjysem pas vendimit te keshillit te Ministrave, filloi nga funksioni Qendra e Trajnimit dhe Kualifikimit per arsim (QTKA). Kjo Qender nuk ka akoma nje statut te saj dhe po te shtojme edhe parregullsi te tjera ligjore, veprimtaria e saj behet edhe me e veshtire per t'iu pergjigjur kerkesave te shumta per trajnim cilesor

Drejtorite Arsimore rajonale kane ne perberjen e tyre dhe nje department qe ka pergjegjesine e trajnimit dhe keshillimit te mesuesve, kurse zyrat arsimore te rretheve e kane trajnimin dhe keshillimin e mesuesve si detyren me kryesore te tyre.

Organizimi i trajnimeve dhe zhvillimi i tyre

Seminaret dhe kurset e ndryshme organizohen ne kete menyre:

- a) Qendra e trajnimit dhe kualifikimit per arsimin dergon ne DAR programe trajnimi te rekomanduara per te gjitha profilet lendore dhe nivelet e shkollimit. Keto programe, Drejtorite Arsimore Rajonale i perdorin per te hartuar programet per mesuesit e rajoneve te tyre. Programet jane per trajnime **perfeksionimi**, por edhe per rritjen e shkalles se kualifikimit te mesuesve (**atestimi**). Programet realizohen gjate vitit mesimor nepermjet seminareve qe zhvillohen ne qarqe, rrethe, ne grup shkollash dhe brenda shkollave.

- b) QTKA organizon seminare kombetare ne Tirane, me pjesemarres nga te gjitha DAR. Ne keto seminare trajneret jane autore e programeve dhe teksteve te reja specialiste te metodave te mesimit dhe te edukimit, pedagogje universitetesh, mesues, trajnere etj.
- c) QTKA dhe IKS botojn enje sere materialesh pedagogjike ne ndihme te DAR dhe per shitje te lire te mesuesve.
- d) Specialistet e QTKA ka raste qe mbeshtesin me trajneret e tyre, trajnimet qe behen ne rajone te ndryshme.
- e) Edhe Ministria e Arsimit dhe Shkences zhvillon seminare trajnimi per çeshtje te ndryshme, po ashtu edhe universitetet.
- f) Seminare trajnimi organizojne edhe Organizata te pavarura si Qendra per arsim Demokratik (CDE), Qendra Hap pas hapi, Qendra e zhvillimeve humane (QZHH) etj.

Tipet e kurseve

Kurset qe zhvillohen jane te formave te ndryshme:

- a) Kurset e trajnimit per mesimdhënien e lendeve te ndryshme, ne te cilat perfshihen te gjithë mesuesit, sipas disiplinave qe japin ne mesim.
- b) Seminare disa oreshe, ose nje ditore ne shkolla te ndryshme, net e cilat trajnimi eshte kolektiv (multidisiplinar).
- c) Kurset e kualifikimit per **atestimin** e mesuesve.
- d) Kurse per formimin e **drejtuesve** te shkollave.
- e) Kurse per trajnimin e **trajnerëve** lokale.

Dispozitat normative

Sipas “**Dispozitat normative per arsimin parauniversitar**” te vitit 2002, mesuesi ka te drejte qe te kualifikohet dhe te perzgjedhe metodat qe perdor ne mesim, mirepo pervec kesaj, aktet nenligjore te mesiperme nuk pershkruajne as te drejtat specifike te mesuesve lidhur me trajnimin e tyre, as skemat e organizimit, zevendesimet, pagesat, modalitetet e hartimit te buxhetit, levizjen e fondeve etj. Mangesite ligjore ndikojne ne sistemin e kualifikimit te mesuesve per atestim.

Boshllëku ligjor eshte aq i madh, aq sa drejtorite arsimore te rretheve, edhe sikur te kene fonde, nuk kane ligje as per te paguar trajneret qe mund te ftojne per trajnimin e mesuesve, nderkohe qe edhe sipas ‘Dispozitave normative per Arsimin parauniversitar’, ato vazhdojne te kene mbi vete te tere pergjegjesine per kualifikimin e mesuesve.

Standartet profesionale te mesuesve ne pune

Aktualisht nuk ekzistojne standartet profesionale te mesuesve ne pune. Qendra e kualifikimit dhe trajnimit per arsimin (QTKA), eshte ne proces e siper per hartimin e ketyre standarteve. Qendra e akreditimit dhe e Vleresimit te Arsimit te Larte ka hartuar standartet per pergatitjen fillestare te mesuesve ne fakultetet e mesuesise.

Nevojat individuale te mesuesve

Nevojat e mesuesve per trajnime identifikohen nepernjet disa rrugeve si:

- Deklarimet e vete mesuesve lidhur me nevojat praktike qe u dalin atyre ne pune.
- Ndryshimet e programeve dhe teksteve, ne pergjithesi te kurrikulave.
- Nga raportimet e drejtuesve te shkollave dhe te inspektoreve.
- Nga aktet e reja zyrtare qe dalin.

Monitorimi i cilesise se pergatitjes se mesuesve

Sigurimi i cilesise mbetet nje nga mekanizmat e brendshem monitories te cilesise se pergatitjes se mesuesve ne fakultetet shqiptare. Ai sigurohet nga:

- Monitorimi i veprimtarive te mesimdhënies,
- Niveli i pervesimit te njohurive
- Veprimtarite kerkimore

Drejtuesit e fakulteteve dhe departamenteve te mesuesise shprehen se pengesat kryesore per rritjen e cilesise se pergatitjes se mesuesve jane:

- Mungesa e nje strategjie kombetare te pergatitjes se mesuesve,
- Mungesa e burimeve te afta njerezore dhe te motivuara per mesimdhenien,
- Mungesa e mundesive per bashkepunime ne projekte nderkombetare kerkimi per mesimdhenien,
- Mungesa e burimeve te mjafta financiare
- Mungesa e laboratoreve dhe bazes materiale didaktike per mesimdhenie cilesore
- Niveli i ulet i studenteve qe vijne ne fakultetet e mesuesise
- Menaxhim ende i vjeteruar i procesit mesimor ne universitet
- Mungesa e standarteve per interpretim cilesor te pergatitjes
- Rezistenca institucionale ne reformimin e pergatitjes se mesuesve
- Mungesa e gadishmerise te stafave akademike per te punuar ndryshe
- Shkolla e vjeter, mesues te rinj apo shkollat e re, mesues arkaike, e njejta gje,
- Legjislacioni parallel ne reformim

Struktura e trajnimit te mesuesve

Perfundim 1

Sistemi aktual i trajnimit dhe kualifikimit te mesuesve eshte ne krize. Veprimtarite qe zhvillohenuk jane te strukturuara, jane te paorganizuar dhe nuk shoqerohen me materiale dhe veprimtari te mepastajme. Trajneret jane te papergatitur dhe nuk kane statusin profesional per te qene te tille. Nuk ekziston ndonje strukture shtetere apo organizem qe te akreditoje programet e trajnimit te mesuesve.

Rekomandim 1

- Te hartohet nje politike kombetare e trajnimit dhe kualifikimit te mesuesve e cila te marre parasysh ngritjen e kapaciteteve kombetare dhe lokale
- Trajnimet te zhvillohen mbi bazen e nevojave te mesuesve te shprehura ne nje katalog profesional.

Akreditimi i programeve te trajnimit te mesuesve

Perfundim 2

Ne Shqiperi nuk ekziston asnje strukture shtetere apo organizem eq te akreditoje programet e trajnimit te mesuesve. Per me teper nuk ka ndonje mekanizem te konvertimit te programeve ekzistuese ne pike kredi dhe te njihen keto per zhvillim profesional, promovim ne detyre dhe ne page. Po ashtu mesuesit qe diplomohen nga universitete nuk licensohen me pas nga punemarresit por diploma u jep automatikisht te drejten e profesionit te mesuesit dhe atestimi zhvillohet me pas si nje procedure formale e bazuar ne vjetersine e mesuesve.

Rekomandim 2

- Programet e trajnimit te akreditohen nga nje institucion/zyre shtetere
- Te filloje procedura e licensimit te mesuesve

Referenca:

“RAPORT KOMBETAR NGA SHQIPERIA” projekt kerkimor nderkombetar, permiresimi i zhvillimit profesional te mesimdhenesve dhe te praktikave te mesimdhenies, te nxenit ne vendet e EJT. **Autor:** Dr. Bardhyl Musaj, Profesor i Asociuar, CDE; Dr. Petrit Muka, Professor i Asociuar, QTKA; Dr. Milika Dharmo, Profesor i Asociuar, UT; Dr. Edmond Rapti, Profesor i Asociuar, UT.